



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.191/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.191/2025 e datës 24.01.2025
- II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1,500.00 (njëmijepesëqind) euro,
- III. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 24.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje, në Suharekë ka identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike, të kandidatës për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Shemsije Bytyqi, në rrugën "Hajdin Berisha", në Suharekë. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime kandidatja dhe subjekti politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit

NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Tutje parashtruesi i ankesës thekson se përmes këtyre veprimeve, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore dhe ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Më datë 25.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë deri me 26.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë, paraqitur me datë 26.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka theksuar se pretendimi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) se kandidatja për deputete nga LDK, znj.Shemsije Bytyqi ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 është konsumuar me rastin e vendimit të nxjerrë nga PZAP Anr.163/2025, ku disa kandidatë të LDK-së, në Suharekë përfshirë edhe të lartcekurën janë gjobitur në shumë prej 4.000 euro, andaj ri-ankimimi për një rast të njëjtë nënkupton hedhje poshtë të ankesës në fjalë. Më tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se për më tepër janë evituar të gjitha shkeljet ku përfshihet ky rast, por që subjekti politik LVV ka tentuar të bëjë një rreng duke ndryshuar vetëm emrin e rrugës në ankesë (konsiderojmë se është edhe rast ku ka abuzim me të drejtën e ankesës-andaj përmes kësaj përgjigje në ankesë kërkojmë dënim për subjektin LVV) e cila nuk quhet rr.”Hajdin Berisha” por rr.”Brigada 123” e për të cilat janë evituar të gjitha shkeljet paraprakisht dhe është marrë vendimi, por kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res judicata).

Përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga PZAP që të marrë vendim meritor për rastin në fjalë duke e hedhur poshtë si të palejuar ankesën e subjektit politik LVV si dhe të konsideroj shkeljen e nenit 34 paragrafi 1.11 nga ana e subjektit LVV.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LDK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se në rrugën, “Hajdin Berisha”, në Suharekë në hapësirat/rrugët publike, subjekti politik LDK kishte vendosur banerë/posterë të kandidatës për deputete Shemsije Bytyqi, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën

paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli shqyrtoi edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK, por se te njetat i gjeti si te pabazuara në fakte dhe prova për arsye se nuk qendrojnë pretendimet se për këte çështje është vendosur me vendimin Anr 163/2025 për arsye se me këtë vendim është vendosur për posterat që kanë qenë vendosura në rrugët Brigada 123 dhe në rrugën Xhavit Bajraktari e ku subjekti politik në përgjigjen e datës 163/3 të datës 25.01.2025 kishte larguar posterat e kandidatëve të tyre nga vendet ku ishin të vendosura dhe largimi i atyre posterave nuk ka të bëjë fare me lokacionin për të cilën është parashtruar ankesa Anr 191/2025. Andaj subjekti politik LDK në momentin që është njoftuar me ankesën Anr 191/2025 menjëher ka marrë masa përmasues dhe ka larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato. Për Panelin si këto prova merren si rrethane lehtësuese.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfutur i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20,000.00) euro.


Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjti apo ngjashëm, subjektin politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Me rastin e vendosjes për lartsinë e gjobës paneli vlerësoj si rrethane lehtësuese provën e siguruar me rastin e përgjigjes në ankesë nga subjekti politik LDK, ku shifet se është larguar posterat në fjalë.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nënparagrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 191/2025 më datë 27.01.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.